



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Glllogocit Burim Bujupi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<i>pen</i> Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbllin Hetemi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 06.02.2026 VI-020-683/4
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 02 Nr. 020/04-4465 për plotësim ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 02 Nr. 020/04-53198 të datës 18.12.2025
I miratuar më datë: 30.01.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 020/04-4465 për plotësim ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 02 Nr. 020/04-53198 të datës 18.12.2025.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, është bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 34 të Statutit të Komunës së Glllogocit, në nenet 3, 4, 5, 6 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, me të cilin vendim është bërë plotësim ndryshimi i Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 02 Nr. 020/04-53198 të datës 18.12.2025.

Akti është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Glllogocit me datë 30.01.2026, është miratuar më 27 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik opštine Glogovac Burim Bujupi, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc::	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administarciju dokumenata u opštini	
Preko:	<i>pen</i> Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,	<i>Docent</i> <i>Docent</i>
Od:	Erbllin Hetemi, rukovodioc Pravnog odeljenja / MALS	Dana 06.02.2026 VI-020-683/4
Odgovorni službenici:		
1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika <i>Xhevat Tafa</i>	
2.Službenik/ca za izradu pravne ocene	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata <i>Vjosa Ahmetaj</i>	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac	
Vrsta odluke:	Odluka	

Poštovani/a gradonačelnice/e,

Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 02 br. 020/04-4465 o dopuni izmeni Odluke o osnivanju Odbora za politiku i finansije 02 br. 020/04-53198 od 18.12.2025. godine

Usvojena dana, 30.01.2026.god

Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 02.02.2026.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština Opštine Glogovac je na sednici održanoj dana, 30.01.2026.godine, odobrila Odluku 02 br. 020/04-4465 o dopuni izmeni Odluke o osnivanju Odbora za politiku i finansije 02 br. 020/04-53198 od 18.12.2025. godine.

MALS konstatuje da usvojena odluka od strane Skupštine opštine Glogovac, zasnovana na članovima 11, 12. i 40. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 34 Statuta opštine Glogovac, članovima 3, 4, 5, 6 Administrativnog uputstva (MLS) br. 05/2020 o postupcima osnivanja, sastavu i nadležnosti stalnih odbora i drugih odbora u opštini, kojom odlukom je dopunjena izmenjena Odluka o osnivanju Odbora za politiku i finansije 02 br. 020/04-53198 od 18.12.2025. godine.

Akt je usvojen na sednici Skupštine opštine Glogovac dana, 30.01.2026., godine, sa 27 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 020/04-53198 dt. 02/02/2026

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA		
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data:	02.02.2026	
Datum:		
Njësia organizative:	Nr. i Lendës:	Vlera:
-VI-	020-683/4	



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3, 4, 5, 6 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë si dhe bazuar në Aktin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr.020/683/2 i datës 15.01.2026 për shqyrtim të ligjshmërisë së aktit. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026 miratoi këtë:

Vendim

për plotësim-ndryshimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe
Financa Nr. 02 Nr. 020/04-53198 të datës 18.12.2025

Neni 1

Miratohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në këtë përbërje:

1. Burim Bujupi-Kryesues (PDKRLL)
2. Selman Qallapeku-Anëtar (PDKRLL)
3. Fitore Morina-Anëtare (PDKRLL)
4. Pajtime Berisha-Anëtare (PDK)
5. Arigon Sinani-Anëtar (PDK)
6. Egzona Tërdevci -Anëtare (VV)
7. Arbër Halilaj-Anëtar (BD)

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet pika I e vendimit Nr. 02 Nr. 020/04-53198 të datës 18.12.2025, kurse pjesa tjetër e tij mbetet e pandryshuar.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset : Zyra e Kryetarit dhe Kuvendi Komunal i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës



Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Burim Bujupi

ARSYETIM

Themelimi i komiteteve të përhershme është përcaktuar me nenin 51 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë.

Komiteti për Politikë dhe Financa themelohet dhe është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik; kornizën vjetore buxhetore afatmesme; planin vjetor të prokurimit; rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat; buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2025, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 020/04-53198 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimi 02 Nr. 020/04-53198 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së i njëjti vlerësohet se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore si dhe me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Në nenin 6, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, parashihet se: "Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji."

Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqindje (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.

Ndërsa neni 5 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, përcakton se:

"Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi".

Bazuar në të lartcekurat si dhe bazuar në aktin e MAPL-së nr.020/683/2 i datës 15.01.2026 Kuvendi i Komunës së Glllogocit duhet të ndërmerë veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Prandaj duke pas parasysh rekomandimet e MAPL-së ky vendim rishqyrtohet në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal te dt. 30.01.2026.